



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

---

**ADGJTHFR.4/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për inicimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga pala ankuese av. A.K. nga Prishtina, Rr. “...” pn. Objekti i P.G., ..., Hyrja ..., me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj F.A., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 18 prill 2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, F.A., e paraqitur nga pala ankuese av. A.K. nga Prishtina, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate - kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, *(në tekstin e mëtejme autoriteti kompetent)*, më 24 mars 2023 ka pranuar ankesën e ushtruar nga ankuesi av. A.K., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj F.A.

Ankuesi av. A.K., në ankesën e ushtruar ka theksuar se me datë 3 shkurt 2023 zyrtari përgjegjës në protokollin e parashtrësës gabimisht ka vendosur datë 3 janar 2023, pasi ka qenë ditë pushimi në muajin janar. I autorizuari i palës kreditore ka bashkangjitur autorizimin për përfaqësim

të Shoqatës “S.IMF”, të ish punëtorëve të Fabrikës së Tubave të çelikut – IMK nga Ferizaj, ku si avokat paraqitet A.K., së bashku me avokatët me seli në SHBA dhe W.E.N. dhe S.B.. I njëjti thekson se me këtë kërkesë është kërkuar që të paisen me kopjet e shkresave të lëndës për shkak të mungesës së disa prej tyre, të cilat nuk i posedonin me qëllim për të mbrojtur interes e pales në këtë çështje përmbarimore.

Ankuesi tutje thekson në pretendimin e tij se gjyqtari i çështjes pa dhënë ndonjë arsyeje ka shpërfillur kërkesën e palës dhe ka vepruar në mënyrë subjektive, duke mos i zbatuar detyrat dhe përgjegjësit e tij me të cilën ngarkohet sipas ligjit. Në këtë mënyrë thekson se i njëjti ka shkëlur ligjin në rastin kur nuk i ka dorëzuar kopjet e shkresave të lëndës pales dhe nuk ka kthyer përgjigje. Për më tepër i njëjti ka theksuar se pas shumë diskutimeve me zyrtarët përgjegjës në zyrën e përmbarimeve është njoftuar se gjyqtari i çështjes e ka dërguar lëndën komplet me ankesë në Gjykatën e Apelit. Gjithashtu, ankuesi av. A.K. në parashtresën e tij ka theksuar se konsideron se ky veprim është e pakuptueshëm si dhe përmbanë bazë të thyerjes së etikës së pozitës së gjyqtarit, ngase ka pasur kohë të mjaftueshme për të kthyer përgjigje rreth kësaj kërkesë dhe si pasojë e lëshimeve të bëra nga ana e gjyqtarit të çështjes pala nuk ka pasur mundësi të deklarohet për ankesën e palëve në procedurë për përfaqësim siç e kërkon legjislacionit në fuqi, duke e njoftuar autoritetin kompetent se është obliguar të inicojë kërkesë të përafërt edhe në Gjykatën e Apelit të Kosovës për paisje me shkresa të lëndës.

Andaj, i ankuesi kërkon që të shqyrtohet kjo ankesë dhe të vlerësohet më tutje si e bazuar për arsyeje e përmendura dhe kërkon që ndaj të njëjtit të ndërmerret masa disiplinore bazuar në Ligjin për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Për më tepër shih<sup>1</sup>.

Gjyqtari i ngarkuar me këtë çështje F.A., në deklaratën e tij me shkrim lidhur me pretendimet e palës ankuese, ka theksuar se: fillimisht thekson se meqenëse lënda e evidentuar si: E.nr.469/05, e datës 30 dhjetor 2022 gjendet në vendosje në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, duke shtuar se në mungesë të shkresave të lëndës i njëjti në deklaratë nuk mund të përdor numra apo data të sakta sa i përket autorizimeve nga pala të cilat gjenden në shkresa të lëndës. Duke shtuar se më datë 27 maj 2019 Gjykata në këtë çështje përmbarimore ka mbajtur seancën dëgjimore publike në të cilën janë prezantuar i autorizuari i përfaqësuesit të S.IMK-së në Ferizaj si dhe përfaqësuesi nga AKP-ja – Zyra Regjionale në Gjiilan. Duke theksuar se përfaqësuesi i S.IMK-së av. S.D. nga Gjakova, me datë 29 korrik 2022, në këtë gjykatë ka

---

<sup>1</sup> Parashtresa kundër gjyqtarit F.A. nga av. A.K. dt. 24.03.2023.

dorëzuar propozimin, kërkesën me shkrim, me të cilën ka bërë zgjerimin e propozimit për përmbarrim në kuptimin subjektiv, duke i propozuar gjykatës që të caktohet përmbarrimi edhe ndaj debitorit të dytë Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës e numër REF.nr.-AGJ.75/10, me numër të rastit KI.nr.08/09, të datës 17 dhjetor 2010.

Gjyqtari i kësaj çështjes F.A., thekson se gjykata duke vendosur në propozimin e të autorizuarit të përfaqësuesit të S.IMK-së, me aktvendimin e datës 10 tetor 2022, e ka pranuar në tërësi propozimin e lartpërmendur dhe ka caktuar përmbarrimin edhe ndaj debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas aktgjykimit REF.nr.-AGJ 75/10, me numër të rastit KI.nr. 08/09, të datës 17 dhjetor 2010, të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Duke shtuar se kundër aktvendimit të datës 10 tetor 2022, debitorët kanë ushtruar prapësim, brenda afatit ligjor, kurse gjykata me aktvendimin e datës 30 dhjetor 2022, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, gjegjësisht e ka hedhë si të palejueshëm prapësimin e përfaqësuesit të debitorit NSH - IMK - Ferizaj, AKP zyra regjionale në Gjilan, ndërsa ka vendosur të mbetet në fuqi aktvendimi i datës 10 tetor 2022.

Gjyqtari i çështjes në deklaratë thekson sa i përket pretendimeve e av.A.K. si i autorizuar i kreditorit A.A. në ankesë, përkatësisht se gjyqtari i çështjes nuk i ka dorëzuar kopjet e shkresave të lëndës palës dhe nuk ka kthyer përgjigje dhe pretendimi se ky veprim përbën bazë të thyerjes së kodit të etikës së gjyqtarit, deklarohet se me konkluzionin me shkrim të datës 21 mars 2023 gjykata ka njoftuar dhe i është përgjigjur me shkrim të autorizuarit të kreditorit A.A. – av.A.K., të cilin e ka njoftuar se: *“Lënda E.nr.469/05, sipas ankesave të debitorëve IMK – Ferizaj – AKP dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, të ushtruara kundër aktvendimit të datës 30.12.2022, gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë”*. Për më tepër në këtë rast nuk ekziston ndonjë lloj shkelje të kodit të etikës për gjyqtar, sepse gjykata në rastin konkret por edhe në të gjitha lëndët tjera ka vepruar, vepron dhe ndërmerri veprime procedurale gjithmonë në pajtim të plotë me të gjitha dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, Ligjit për Procedurën Kontestimore si dhe ligjet tjera në fuqi dhe rrjedhimisht gjithmonë në shërbim të palëve.

I njëjti ka shtuar se është me rëndësi të theksohet se bazuar në nenin 107 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila tregon se gjyqtarët në punën e tyre, janë të pavarur dhe vendosin sipas provave dhe fakteve të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe sipas ligjeve në fuqi. Rrjedhimisht gjykata, përkatësisht gjyqtari i çështjes në këtë rast por edhe në të gjitha rastet

tjera që ngarkohet më lëndë, ka vendosur në bazë të nenit 17 të LPP-së lidhur me nenin 8.1 të LPK-së, në të cilën shprehimisht është theksuar: *“Se cilat fakte do t’i konsideroj të provuara e cilat jo, vendos vet gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit”*. Rithekson se të gjitha veprimet procedurale të cilat janë ndërmarrë në lëndën E.nr.469/05, janë veprime që janë ndërmarr brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive si gjyqtar, së pari në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenit 107 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-006, për Procedurën Kontestimore, të Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe Ligjit për Gjykatat në Republikën e Kosovës, si dhe me të gjitha ligjet tjera në fuqi.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit të rastit si dhe shkresave tjera që ka bashkangjitur pala ankuese ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga gjyqtari F.A.

Kryetari i Gjykatës vlerëson se pretendimet e palës ankuese në rastin konkret nuk qëndrojnë, nga faktet të cilat gjenden në shkresa të lëndës vërtetohet saktë se gjyqtari F.A., përkatësisht, zyra e përmbartimeve kanë ndërmarrë të gjitha veprimet lidhur me procedimin apo përfundimin e kësaj çështje, gjyqtari i çështjes ka potencuar të gjitha veprimet e ndërmarra (të cilat janë të shënuar më lart, tek përshkrimi i deklaratës së gjyqtarit).

Sipas vlerësimit të Autoritetit kompetent theksimet e palës ankuese në ankesën e tij me shkrim, më tepër janë në atë drejtim se gjyqtari i çështjes nuk ka dorëzuar shkresat që ka kërkuar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit –ankuesi. Mirëpo Autoriteti Kompetent pas analizimit të shkresave të lëndës dhe deklaramit të gjyqtarit vlerëson se gjyqtari i rastit ka ndërmarrë të gjitha veprimet në pajtim me Ligjin për Procedurën Përmbartimore, gjithashtu vërehet qartë se gjyqtari ka vepruar konform dispozitave të nenit 107 paragrafi 1 të LPK-së, palëve dhe të autorizuarve të tyre të cilët kanë marrë pjesë në seancën dëgjimore, i ka dorëzuar shkresat dhe vendimet e marra nga gjykata në rastin konkret. Gjyqtari i çështjes po ashtu me konkluzionin e datës 21.03.2023 gjyqtari i çështjes e ka njoftuar ankuesin i cili me parashtresë të datës 03.02.2023 i është drejtuar gjyqtarit për dorëzimin e kopjes së shkresave të lëndës E.nr.496/05, se kjo lëndë nga data 10.02.2023 gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës, dhe në mungesë të shkresave të lëndës gjykata e ka të pamundur të siguroj shkresat e kërkuara dhe se posa të kthehen shkresat në fjalë pas vendosjes sipas ankesës së ushtruar, gjykata menjëherë dot të iu dorëzoj shkresat e kërkuara. Andaj, duke marrë parasysh veprimet e ndërmarra nga ana e

gjqtarit në trajtimin e kësaj çështje, nuk mund të konkludohet se ka pasur ndonjë shpërfillje apo veprim subjektiv në raport me palët sa i përket mënyrës së trajtimit të kësaj lënde dhe përcjelljen e shkresave dhe vendimeve tek personat e autorizuar në këtë çështje përmbarimore deri në momentin e dërgimit të lëndës për në Gjykatën e Apelit, për faktin se të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në lëndën E.nr.469/05, janë veprime që janë ndërmarr brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive si gjyqtar në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe Ligjin për Procedurën Përmbarimore.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, si dhe bazuar në të dhënat e përshkruara si më lartë Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillim të hetimeve disiplinore.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**ADGJTHFR.4/23**

**18 prill 2023**

**Mustaf TAHIRI**

---

**Kryetar i Gjykatës**

### **Iu dërgohet:**

- Av. A.K. nga Prishtina, Rr. “...” pn. Objekti P.G., ..., Hyrja ..- Parashtrues i ankesës
- F.A. - Gjyqtar
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës